



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.31.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË
MINIERAVE DHE MINERALEVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË
31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga Udhëheqësi i ekipit, Jusuf Kryeziu dhe anëtarëve të ekipit Shqiponja Krasniqi, Saranda Husaj dhe Fatlinda Podvorica.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| Përmbledhje e përgjithshme..... | 4 |
| 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 6 |
| 2 Qeverisja..... | 9 |
| 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli..... | 13 |
| Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit | 22 |
| Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP | 23 |
| Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak | 26 |


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) të sektorit publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 06/10/2015

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Kryesuesit të Bordit - auditimi 2015

Kryesuesi i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Komisionit për Miniera dhe Minerale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i KPMM-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KPMM-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

KPMM duhet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr.04/L-116 dhe Ligjin nr.04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren e MF-së nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të Buxhetit për vitin 2015;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për obligimet e papaguara, dhe
- Planin preliminar dhe final të prokurimit.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 23/11/2015, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KPMM - në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve dhe të hyrave (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar si mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është marrë në konsideratë nga menaxhmenti i KPMM-së. Ky është një tregues që KPMM ka bërë përpjekje t'i përmirësoj proceset ekzistuese dhe të instaloj një qeverisje efektive. Megjithatë, disa rekomandime mbesin të pa implementuara dhe për pasojë mangësi të njëjta përsëriten çdo vit. Me theks të veçantë, rekomandimet lidhur me të arkëtueshmet dhe menaxhimin e të hyrave.

Megjithatë, shqetësuese mbetet fakti që KPMM nuk ka të hartuar planin strategjik dhe vjetor të punës, në të cilin do të përcaktoheshin qartë objektivat e organizatës dhe në bazë të saj do të hartohej edhe plani i monitorimit dhe vlerësimit të progresit të arritjes së objektivave. Mos përgatitja e planit strategjik dhe vjetor të punës ka pasur për pasojë edhe mos përgatitjen e regjistrit të rreziqeve nga KPMM dhe planeve përcjellëse për monitorimin e tyre.

Më tutje, NjAB si hallk kyç e sistemit të kontrollit të brendshëm ka arritur të mbështesë menaxhmentin lidhur vlerësimin e kontrolleve të brendshme në KPMM.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014, ka rezultuar me 10 rekomandime. KPMM ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, pesë (5) rekomandime janë implementuar një (1) pjesërisht, përderisa katër (4) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Përkundër progresit në implementimin e rekomandimeve të AP-së, KPMM ende nuk ka arritur të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për adresimin e plotë të tyre. Si pasojë mangësitë e njëjta janë përsëritur në menaxhimin e të hyrave dhe inkasimin e të arkëtueshmeve.
- Rreziku** Mos implementimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të dobësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontroleve apo edhe humbje financiare.
- Rekomandimi 1** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP për vitin e kaluar.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për KPMM-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, ne i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:
1. KPMM nuk ka të hartuar planin strategjik dhe vjetor të punës dhe si rezultat mungon edhe përcaktimi i objektivave të qarta dhe planit për monitorimin e arritjes së tyre. Është e rëndësishme që institucionet publike të hartojnë planet e tyre strategjike dhe vjetore për të mundësuar më pas përqendrimin në arritjen e rezultateve të orientuara drejt planifikimit. Megjithatë, në vitin 2016 KPMM ka hartuar planin vjetor dhe ka përcaktuar objektivat për këtë vit.
 2. Po ashtu, nuk kishte të hartuar as regjistrin për menaxhimin e rrezikut (kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1).
- Rreziku** Mos hartimi i planit strategjik dhe vjetor të punës nuk siguron që të punësuarit në KPMM dhe akterët tjerë punojnë drejt qëllimeve të përbashkëta dhe drejt rezultateve të synuara. Kjo mund të mos i kontribuoj stabilitetit organizativ në përgjithësi. Ndërsa, mungesa e planit të veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave shkakton paqartësi rreth synimeve të organizatës.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar planin strategjik për të mundësuar monitorimin e progresit dhe vlerësimin e rezultateve të arritura.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit operon KPMM, dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Menaxhimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritjet që të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Dispozitat e LMFPP-së si dhe Rregulla Financiare e Thesarit nr. 01-2010 përcaktojnë që ZKA është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçe të organizatës dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për të menaxhuar ato rreziqe.

Çështja 3 – Sistemi për menaxhimin e rrezikut – prioritet i lartë

| | |
|----------------------|--|
| E gjetura | KPMM nuk ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve. KPMM, nuk kishte të hartuar regjistrin për menaxhimin dhe vlerësimin e rrezikut, me qëllim të zvogëlimit të tyre në nivel të pranueshëm. |
| Rreziku | Mos përgatitja e regjistrit të rreziqeve ndikon që menaxhmenti të mos identifikojë dhe të menaxhojë rreziqet të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të organizatës. |
| Rekomandimi 3 | Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar regjistrin e rreziqeve si operative ashtu edhe financiare si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës. |

2.5.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

NjAB përbëhet nga një auditor i cili ka licencë të përkohshme dhe është në proces të licencimit. Kjo njësi i kryen aktivitetet e saja sipas planit strategjik dhe atij vjetor dhe i raporton Komitetit të auditimit.

Komiteti i auditimit është i themeluar nga Bordi dhe është i përbërë nga 3 anëtarë. Komiteti i auditimit për vitin 2015 ka mbajtur katër takime, ku janë diskutuar të gjeturat dhe implementimi i rekomandimeve të KPMM-së. Në takimin e parë të mbajtur të komitetit, ky komitet ishte i përbërë nga dy anëtarë për shkak se njërit anëtar i kishte përfunduar mandati dhe ende nuk ishte formuar bordi i ri për të zgjedhur anëtarin e tretë. Mirëpo, me fillim të punës së bordit është përzgjedhur anëtari i tretë i këtij komiteti dhe komiteti kishte vazhduar mbajtjen e takimeve gjatë vitit.

NjAB është funksionale dhe ka operuar në bazë të planit dhe përgjegjësive të caktuara. NjAB ka një plan vjetor të auditimit për 2015, në bazë të të cilit ka paraparë kryerjen e pesë (5) auditimeve. Deri në fund të vitit 2015, kjo njësi ka kryer të gjitha auditimet e planifikuara.

Vlerësimi ynë është se raportet e NJAB-së janë cilësore dhe menaxhmentit i kishin ofruar pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të operimit të kontrolleve të brendshme, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me këtë fushë.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, të hyrave, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, subvencionet, pasuritë, të arkëtueshmet si dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor marrë si tërësi janë të mira. KPMM ka arritur të realizoj 95% të buxhetit final për vitin 2015.

Më tutje, në vitin 2015 performanca e mbledhjes së të hyrave në KPMM krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar. Në raport me vitin 2014 kishte realizim më të lartë të të hyrave për 3,174,473€ apo shprehur në përqindje 12% rritje. Megjithatë, kontrollet mbi menaxhimin e licencave, sigurimin e garancioneve bankare dhe parandalimin e aktiviteteve ilegale, kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm. Ato në raste të caktuara ishin shmangur nga legjislacioni në fuqi. Në këtë aspekt, kontrollet duhet të forcohen për të siguruar që objektivat e KPMM-së arrihen.

Auditimi ynë i këtij viti nuk ka identifikuar ndonjë mangësi domethënëse në menaxhimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime si dhe për paga dhe mëditje, me përjashtim të një rasti specifik. Megjithatë, kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm.

Gjithashtu, të hyrat e pa arkëtuara kërkojnë vëmendjen e menaxhmentit të KPMM-së për të siguruar se do të shtohet efikasiteti në menaxhimin dhe inkasimin e tyre. Kjo për faktin që, llogaritë e arkëtueshme në vitin 2015 krahasuar me 2014 janë rritur për 8%.

Në këtë aspekt, inkurajojmë menaxhmentin e KPMM-së të marr në konsideratë përfitimin nga puna e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për të ngritur nivelin e kontrolleve në fushat me mangësi të theksuara.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për KPMM, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ¹ | 2015 Shpenzimi | 2014 Shpenzimi | 2013 Shpenzimi |
|----------------------------|-------------------|----------------------------|------------------|------------------|-------------------|
| Burimet e Fondeve: | 1,275,817 | 1,186,273 | 1,129,637 | 1,552,999 | 1,373,1010 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 1,275,817 | 1,186,273 | 1,129,637 | 1,552,999 | 1,373,101 |

Buxheti final ishte më i ulët se buxheti fillestar për 89,544€. Sqarimet lidhur me ndryshimet në buxhetin final të KPMM-së janë dhënë poshtë tabelës 2.

Në vitin 2015, KPMM ka realizuar rreth 95% të buxhetit final ose 1,129,637€. Në përgjithësi ekzekutimi i buxhetit për vitin 2015 mbetet në nivel të mirë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2015 Shpenzimi | 2014 Shpenzimi | 2013 Shpenzimi |
|--|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 1,275,817 | 1,186,273 | 1,129,637 | 1,552,999 | 1,373,101 |
| Pagat dhe Mëditjet | 772,518 | 712,787 | 712,787 | 619,388 | 597,866 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 402,699 | 385,431 | 331,864 | 355,589 | 341,131 |
| Shërbimet komunale | 30,600 | 25,055 | 22,327 | 22,862 | 21,706 |
| Transfere dhe subvencione | 20,000 | 13,000 | 13,000 | 0 | 0 |
| Investimet Kapitale | 50,000 | 50,000 | 49,659 | 555,160 | 412,398 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 59,731€. Zvogëlimi është bërë me vendim të Qeverisë. Buxheti për këtë kategori për 2015 është shpenzuar 100%.
- Buxheti final për Mallra dhe Shërbime në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 17,268€. Zvogëlimi është bërë me vendim të Qeverisë. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar rreth 86%.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 5,545€. Buxheti final është shpenzuar rreth 89%.
- Buxheti final për subvencione në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 7,000€. Buxheti final është shpenzuar rreth 100%.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar rreth 99%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me këtë fushë.

3.4 Të Hyrat

Të hyrat e gjeneruara nga KPMM në vitin 2015 ishin në total 30,141,403€, përderisa planifikimi i të hyrave nga KPMM për vitin 2015 ishte 28,138,000€. Në raport me vitin e kaluar, KPMM ka shënuar realizim më të lartë të të hyrave për 3,174,472€, apo rreth 12%. Rritje më të madhe tregohet tek renta minerare. Në vijim do të paraqesim në mënyrë të detajuar të hyrat për vitin 2015.

Tabela. 3 Të hyrat e detajuara sipas llojit (Janar-Dhjetor/2015)

| Nr. | Përshkrimi | Vlera në Euro (€) |
|---------------------------|----------------------|-------------------|
| 1 | Taksa Administrative | 292,390 |
| 2 | Gjoha Administrative | 149,503 |
| 3 | Renta Minerare | 29,699,510 |
| Të Hyrat në Total: | | 30,141,403 |

Ne kemi ekzaminuar 100 mostra (teste thelbësore), kryesisht në të hyrat nga: Renta Minerare, Gjoha Administrative dhe Taksa Administrative, si dhe kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë për disa mostra. Si rezultat i ekzaminimit të mostrave në kategorinë e të hyrave dhe analizimit të tyre doli që:

Çështja 4 - Bartësit e licencave nuk kanë raportuar në periudha vjetore në KPMM - Prioritet i lartë

- E gjetura** Në 10 raste të ekzaminuar, doli që bartësit e licencave për shfrytëzim nuk kishin raportuar në departamentet përkatëse në KPMM për sasinë apo vëllimin e mineraleve të prodhuara, si dhe vlerën e rentës minerare të prodhuar për vitin përkatës në përputhje me nenin 34, paragrafi 4.2 të Ligjit 03/L-163. KPMM kishte lëshuar aktvendimet për pezullimin e licencave për këto kompani.
- Rreziku** Mos raportimi i rregullt nga ana e bartëseve apo shfrytëzuesve të licencës për pasojë mund të ketë mungesën e informatave të plota në lidhje me vëllimin e mineraleve të prodhuara si dhe vlerën e obligimeve që e ka secili bartës i licencës ndaj KPMM-së.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa adekuate për të shtuar përgjegjësinë dhe efikasitetin duke siguruar informata të plota lidhur me vëllimin e mineraleve të prodhuara dhe aktivitetin e shfrytëzuesve të licencave, ashtu siç përcaktohet me kornizën ligjore në fuqi.

Çështja 5 - Mos përmbushja e detyrimeve nga bartësit e licencave - Prioritet i lartë

- E gjetura** Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163, me datën 01/04/2011 Bordi i KPMM-së ka aprovuar vendimet ku të gjitha kompanitë e licencuara obligohen që brenda një periudhe gjashtë mujore të dorëzojnë garancionet bankare dhe sigurimet ndaj palëve të treta në KPMM. Gjithashtu, në përputhje me këtë ligj, Bordi ka nxjerr Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 002/2014 për garancionet bankare dhe sigurimet ndaj palëve të treta, sipas të cilit çdo Licencë apo Leje lëshohet vetëm pasi që aplikuesi, përveç plotësimit të kushteve tjera të përcaktuara me ligj, sjell edhe Garancitë Bankare për përmbushjen e detyrimeve si dhe Sigurimin për Rreziqet ndaj palëve të treta.

Garancionet bankare dhe polisat e sigurimit garantojnë se bartësi i licencës pas skadimit të afatit të licencës ka fonde të mjaftueshme për realizimin e projektit dhe planin për mbylljen e minierës.

Në tri (3) raste të ekzaminuara bartësit e licencave nuk kanë dorëzuar në KPMM polisat e sigurimeve ndaj palëve të treta dhe garancionet për përmbushjen e detyrimeve në formën e përcaktuar nga KPMM. Për këto KPMM kishte lëshuar aktvendimet për mos përmbushje të detyrimeve ndaj KPMM-së dhe për pezullim të licencave.

Rreziku Menaxhimi garancioneve jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore, për pasojë mund të ketë që pas përfundimit të afatit të licencave bartësit e tyre të mos i përgjigjen kërkesave për realizimin e programit rehabilitues të minierave të shfrytëzuara.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa adekuate për forcimin e kontroleve menaxheriale lidhur me licencat, si dhe të siguroj që bartësit e licencave pas skadimit të afatit të kenë fonde të mjaftueshme për rehabilitim e zonave/sipërfaqeve të shfrytëzuara dhe sigurinë ndaj palëve të treta.

Çështja 6 - Mos parandalimi i aktiviteteve/operimeve ilegale - Prioritet i lartë

E gjetura Inspektorët e KPMM-së gjatë vitit kishin identifikuar gjithsej 62 raste të operimeve ilegale. KPMM kishte shqiptuar gjobën administrative për operuesit ilegal në vlerë prej 408,116€, dhe kishte lëshuar urdhëresë për ndërprerjen e aktivitetit ilegal minerar dhe sekuestrimin e mjeteve të punës dhe mineraleve. Më tutje, kishte bërë kallëzim penal në prokurorinë themelore përkatëse si dhe inspektorati kishte bërë identifikimin e mjeteve të punës dhe mineraleve të nxjerra. Mirëpo, nuk ishin marrë veprime të mjaftueshme për sekuestrimin e mjeteve të punës dhe mineraleve të nxjerra nga operuesit ilegal në përputhje me nenin 70 të Ligjit për miniera dhe minerale, neni 43 ligji nr. 04/L-158 për miniera dhe minerale i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe neni 7 i ligjit nr. 03/L-141 për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar.

Rreziku Mos parandalimi i aktiviteteve apo operimeve ilegale mund të ketë për pasojë përdorimin jo të drejt të vendburimeve/pasurive minerale dhe shkatërrimin e tyre si dhe dështimin për grumbullimin e të hyrave si dhe mbrojtjen e interesave të popullatës vendase.

Rekomandimi 6 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj koordinim sa më të mirë ndërmjet sektorit të inspektoratit, si dhe mekanizmave të tjera përkatëse në mënyrë që të ndikoj në parandalimin e aktiviteteve/operimeve ilegale duke siguruar grumbullim të të hyrave dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve (popullatës vendase).

3.5 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Në përgjithësi në KPMM kontrollet kanë funksionuar në mënyrë efektive, megjithatë janë disa mangësi të cilat duhet të adresohen për ta përmirësuar procesin në tërësi.

Çështja 7 – Vonesë në liferim – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në kontratën “Kontrolli i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në KPMM”, pagesa në vlerë 1,550€, Operatori Ekonomik (OE) kishte vonuar ofrimin e shërbimeve të kontraktuara për 15 ditë (ditë pune). Ndërsa KPMM nuk kishte aplikuar penalet për vonesat në ekzekutim edhe pse ato ishin parashikuar me kontratë. Kontrata përcakton që për çdo ditë vonesë të aplikohet norma 0,25% në ditë në sasinë e porositur.
- Rreziku** Mos aplikimi i ndëshkimeve ka ndikuar që KPMM t’i pranoj shërbimet e kontraktuara me vonesë. Mos aplikimi i ndëshkimeve ndaj OE për vonesa ndikon edhe në mos vetëdijesimin e OE që shërbimet e kontraktuara të sigurohen sipas planit dinamik.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se në rast të vonesave të ofrimit të shërbimeve, të aplikohen ndëshkimet.

3.6 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.6.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet që operojnë në KPMM kanë të bëjnë me autorizimin e Payroll-it, një analizim i variancave dhe harmonizimeve të ndryshme. Numri i punëtorëve të planifikuar ishte 79 ndërsa numri i punëtorëve në fund të vitit 2015 ishte 73. Ne nuk kemi identifikuar mangësi në këtë fushë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Subvencionet dhe Transferet

KPMM ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 01/2015 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere. Në këtë kategori ne kemi testuar dy mostra (marrëveshje për dhënien e subvencioneve), në vlerë 13,000€.

Çështja 8 - Dhënia e subvencioneve pa përfunduar projekti dhe dorëzuar raporti nga përfituesi i subvencionit-Prioritet i lartë

E gjetura KPMM në muajin dhjetor 2015 kishte dhënë dy subvencione (OJQ-ve) në vlerë prej 13,000€. Sipas UA nr.01/2015 për ndarjen e subvencioneve në KPMM, kërkohet që menjëherë pas hyrjes së vendimit për ndarje të subvencionit transferohen tek përfituesi 30% të vlerës totale. Përderisa, pjesa tjetër e subvencionit transferohet pas pranimit të raportit nga ana e përfituesit me të cilin dëshmohet përmbushja e planit dhe projektit.

KPMM ka kryer pagesat finale të subvencioneve për këto OJQ pa mbështetjen e dëshmive për përmbushjen e planit apo projektit për të cilin pala ka fituar subvencionin. Mirëpo, pas pranimit të pjesës finale të subvencionit OJQ-të kanë sjellë dëshmitë përcjellëse.

Rreziku Kryerja e pagesave pa u përmbushur plani apo projekti për të cilin është ndarë subvencionin rrit rrezikun për mos arritjen e objektivave të parapara me subvencionim.

Rekomandimi 8 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj menaxhim më efikas të subvencioneve duke vendosur kontrole përkatëse në zbatimin e plotë të marrëveshjeve për subvencionim.

3.8 Pasuritë dhe detyrimet

3.8.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 1,471,245€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 56,619€ si dhe stoqet në vlerë prej 13,325€. Menaxhimi i pasurisë në KPMM është bërë në përputhje me rregulloren e MF-së nr.02/2013 për menaxhimin e pasurive.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8.2 Detyrimet e papaguara

Përshkrim

KPMM, ka shpalosur obligimet e papaguara në Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2015 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore. Vlera e obligimeve të shpalosura është 17,433€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016, përderisa në fund të vitit 2014 obligimet e papaguara kanë qenë në vlerë prej 6,873€.

Çështja 9 - Rritja e obligimeve të pa paguara - Prioritet i mesëm

E gjetura Përderisa obligimet e pa paguara në fillim të vitit 2015 ishin 6,873€, deri në fund të këtij viti obligimet janë rritur për më tepër se dy herë. Vlera e të cilave me 31 dhjetor 2015 është 17,433€. Pjesa më e madhe e obligimeve të papaguara i takojnë shpenzimeve të karburanteve, shërbime të konsulencës, sigurimi fizik i ndërtesës dhe darkë e fund vitit. Sipas zyrtarëve të KPMM-së kjo ka ndodhur si rezultat i pengesave nga ana e Thesarit në realizimin e shpenzimeve në fund të vitit.

Rreziku Rritja e obligimeve të papaguara është indikator për menaxhim jo efikas të parasë publike për vitin fiskal dhe ndikon në buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi 9 Kryesuesi i Bordit duhet të analizoj arsyet për rritjen e obligimeve dhe të siguroj që aktivitetet operative dhe financiare aty ku është e mundur të zhvillohen para muajit dhjetorë. Kjo duhet të bëhet me qëllim që obligimet të mos ngarkojnë buxhetin e vitit vijues.

3.8.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Sipas PVF-ve 2015, KPMM ka shuma të pa arkëtuara të të hyrave në vlerë prej 16,569,620€. Përderisa, në fund të 2014 ishin 15,320,161€. Prej tyre 5,689,692.68€ janë obligime të vazhdueshme të ndërmarrjes Trepça nën menaxhimin e AKP-së.

Çështja 10 - Rritja e të arkëtueshmëve nga viti në vit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Edhe më tej, trajtimi i borxheve të vjetra dhe trendi i rritjes së borxheve të reja mbetet sfidë për KPMM-në. Në krahasim me vitin 2014, borxhet në vitin 2015 janë rritur për 1,249,459€ apo shprehur në përqindje kishte rritje prej 8%.
- Rreziku** Mos arkëtimi me kohë i borxheve e vështirëson arkëtimin e tyre të mëvonshëm si dhe krijon rast precedent për debitorët e tjerë të cilët mund të vendosin të mos paguajnë.
- Rekomandimi 10** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ndërmarrjen e masave të duhura, përfshirë veprimet ligjore në mënyrë që të shtoj efikasitetin në inkasimin e parasë publike.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

| Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Të implementuara | Të adresuara por jo te implementuara | Të pa adresuara |
|--|---|------------------|---|-----------------|
| Rekomandimet e vitit - 2013 | Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak Kryesuesi i Bordit duhet të zbatojë një proces të qartë për monitorimin e adresimit të rekomandimeve të AP-së. Rekomandimet të cilat nuk adresohen sipas afateve, të rishikohen në baza mujore nga Kryesuesi, si dhe veprime pro aktive të ndërmerren ndaj sfidave të paraqitura gjatë zbatimit. | | Pjesërisht. Përkundër progresit në implementimin e rekomandimeve të AP-së, mangësi të njëjta janë prezentë në menaxhimin e të hyrave dhe menaxhimin e të arkëtueshmeve. | |
| 4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit | Planifikim jo i mirë i buxhetit për projekte kapitale Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për projekte kapitale dhe ka ndërmarr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për projekte kapitale ka analizuar mangësitë në procesin e buxhetimit për evitimin e tyre në të ardhmen. | Po | | |
| 4.3 Të hyrat | Mos raportimi i rregullt në periudha tremujore dhe vjetore nga bartësit e licencave Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa adekuate për ta rritur shkallën e përgjegjësis brenda departamenteve përkatëse në mënyre që të rezultoj me ngritje të efikasitetit për raportim në pajtueshmëri me kërkesat ligjore nga bartësit e licencave. | | | Jo |

| | | | | |
|---|---|---------------------|--|---------------------|
| | <p>Mos revokim i licencave apo lejeve në mungesë të garancioneve bankare dhe polisave të sigurimit ndaj palëve të treta</p> <p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa adekuate për forcimin e kontrolleve menaxheriale lidhur me licencat dhe licencat e bartësve të cilët nuk i përgjigjen kërkesave ligjore ndaj KPMM-së të revokohen.</p> <p>Menaxhimi jo efikas i operimeve ilegale</p> <p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj koordinim sa më të mirë ndërmjet sektorit të inspektoratit, zyrës ligjor, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë për administrim dhe sekuestrim të pronës për të pamundësuar ushtrimin e aktiviteteve ilegale.</p> | | | <p>Jo</p> <p>Jo</p> |
| <p>4.4 Shpenzimet 4.4.1 Prokurimi</p> | <p>Dobësi jo sistematike në prokurim-</p> <p>Kryesuesi i Bordit duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë e identifikuar janë adresuar.</p> <p>Dobësi në procedimin e pagesave për furnizim me karburant</p> <p>Kryesuesi i Bordit duhet siguroj se është shtuar bashkëpunimi mes sektorëve përkatëse dhe menaxherit të kontratës me qëllim që me kohë të përgatiten kërkesat me shkrim për çdo furnizim me karburant si dhe se zotohen fondet e më pastaj fillon procesi i furnizimit.</p> | <p>Po</p> <p>Po</p> | | |

| | | | | |
|---|---|----|--|----|
| 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet) | <p>Zhvillimi i procedurave të rekrutimit dhe procesi i gradimeve jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore</p> <p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se gjatë rekrutimit të stafit respektohen kriteret e konkursit publik me qëllim të përzgjedhjes së kandidatëve me shkathtësi dhe përvojën e duhur profesionale për pozitën e caktuar. Po ashtu, duhet të siguroj që procesi i avancimeve është zhvilluar përmes një procesi konkurrues brenda KPMM-së.</p> | Po | | |
| 4.5 Pasuritë dhe detyrimet 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale | <p>Mos përdorimi i programit e-pasuria</p> <p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se ka ngritur çështjen e funksionalizimit të e-pasurisë me Ministrin e Administratës Publike për të siguruar që të gjitha kërkesat për menaxhimin e pasurisë përmbushen në plotësi.</p> | Po | | |
| 4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve | <p>Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshmeve</p> <p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit duke zbatuar masa parandaluese përfshirë edhe revokimin e licencave me qëllim të rritjes së përgjegjësisë së kompanive në përmbushjen e obligimeve dhe me këtë edhe rritjen e inkasimit të parasë publike.</p> | | | Jo |